



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 129

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 26 korrik 2024**

## PËRMBAJTJA

|                                                  | Faqe                                                                                                                                                                                         |
|--------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 68/2024, datë 25.7.2024 | Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 15941       |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 69/2024, datë 25.7.2024 | Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 15941 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 70/2024, datë 25.7.2024 | Për ngritjen e nënkomisionit për auditimin e sektorit publik..... 15941                                                                                                                      |



**VENDIM  
Nr. 68/2024****PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË  
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR  
NGA RADHËT E AVOKATËVE SIPAS  
LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET  
E QEVERISJES SË SISTEMIT TË  
DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Bledar Bajri
2. Albens Tabaku

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 25.7.2024

**VENDIM  
Nr. 69/2024****PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË  
KËSHILLIT TË LARTË TË  
PROKURORISË NGA RADHËT E  
AVOKATËVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2016  
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË  
SISTEMIT TË DREJTËSISË”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i

ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erind Merkuri
2. Erind Gërmenji

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 25.7.2024

**VENDIM  
Nr. 70/2024****PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT  
PËR AUDITIMIN E SEKTORIT PUBLIK**

Në mbështetje të neni 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

II. Fusha e përgjegjësisë së nënkomisionit përfshin shqyrtimin objektiv të zbatimit të buxhetit të shtetit dhe rritjen e ndikimit të proceseve të auditimit. Qëllimi kryesor i nënkomisionit është të rrisë transparencën dhe llogaridhënien dhe të



kontribuojë në përmirësimin e ekonomizimit, efektivitetit dhe efikasitetit në përdorimin e burimeve publike. Gjithashtu, nënkomisioni do të sigurojë llogaridhënien e KLSH-së në Kuvend, pa ndërhyrë në pavarësinë e institucionit.

III. Kompetencat e nënkomisionit janë:

a) shqyrtimi i raporteve të qeverisë për zbatimin e buxhetit të shtetit, i raportit të KLSH-së për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportimi i gjetjeve;

b) shqyrtimi i raporteve të auditimit të KLSH-së, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe raportimi i gjetjeve;

c) organizimi i seancave dëgjimore për çështjet të cilat janë pjesë e fushëveprimit dhe kompetencave të nënkomisionit;

ç) vendimmarrja, dhënia e rekomandimeve dhe trajtimi i përgjigjeve nga institucionet përkatëse;

d) paraqitja e raporteve dhe trajtimi i përgjigjeve apo propozimeve të tjera për çështje të cilat janë pjesë e fushëveprimit dhe kompetencave të nënkomisionit;

dh) shqyrtimi i raportit vjetor të performancës së KLSH-së dhe raporteve të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të KLSH-së;

e) shqyrtimi i projektbuxhetit vjetor të KLSH-së dhe raportimi i gjetjeve të Komisionit për Ekonominë dhe Financat;

ë) ndërmerr procedurat për përzgjedhjen e audituesve të jashtëm të llogarive të KLSH-së dhe ia paraqet rekomandimet Komisionit për Ekonominë dhe Financat;

f) paraqitja e raportit vjetor për veprimtarinë e tij.

IV. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- |                     |                     |
|---------------------|---------------------|
| 1. Emilja Koliqi    | kryetare PD         |
| 2. Enslemvera Zake  | zëvendëskryetare PS |
| 3. Alban Xhelili    | anëtar PS           |
| 4. Pranvera Resulaj | anëtare PS          |
| 5. Sorina Kote      | anëtare PD          |

Anëtar zëvendësues:

Antoneta Dhima PS

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 25.7.2024







|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë

